



SHIFRA
E NXËNËSIT



**PROVIMI I MATURËS/
PROVIMI PROFESIONAL**

GUSHT, 2025

**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**



ME RËNDËSI!

"KANDIDATI HUMB TË DREJTËN E PROVIMIT, NË ATË AFAT TË PROVIMIT, KUR GJATË PROVIMIT, PËRKATËSISHT VLERËSIMIT, VËRTETOHET SE KA PËRDORUR MJETE TË PALEJUARA, SE KA KOPJUAR DETYRËN E DIKUJT TJETËR OSE SE DETYRËN E VET IA KA DHËNË NXËNËSIT TJETËR."

(Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnaz, neni 24; Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e dhënies së Provimit Profesional për nxënës të cilët vazhdojnë arsimimin, neni 27)



Koha për zgjidhjen e testit është 180 minuta.

Lexo me kujdes udhëzimin.

Mjetet e lejuara: lapsi grafit, goma dhe stilolapsi.

Testi DUHET të shkruhet lexueshëm me stilolaps. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe

Gjatë punës në test nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike. Nxënësi/nxënësja në asnjë mënyrë nuk guxon ta zbulojë identitetin e vet në test apo t'i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vlerësuesit.

Lexo me kujdes çdo detyrë.

Me test ke marrë edhe fletën e përgjigjeve për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- përgjigjja është e pasaktë
- përgjigjja në detyrën me zgjedhje të shumëfishtë NUK është kaluar në fletën e përgjigjeve
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja është shkruar me laps të thjeshtë ose laps grafit
- teksti funksional/eseja NUK është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në fletët e konceptit (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri.
Nuk lejohet përdorimi i korrektorit.

Të dëshirojmë shumë sukses!

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

NGROHJA GLOBALE KTHEN MILIONA NJERËZ NË EMIGRANTË KLIMATIK

Organizata Ndërkombëtare për Emigracion (IOM) parashikon se deri në vitin 2050 mund të ketë nga 44 milionë deri në 216 milionë emigrantë klimatik.

Ekspertët sugjerojnë se derisa ndikimet e krizës klimatike intensifikohen, emigrimet klimatike brenda vendit mund të bëhen më të shpeshta.

Ndryshimet klimatike dhe rritja e temperaturave globale po çojnë në fatkeqësi të ndryshme natyrore në shumë rajone të botës.

Pasojat shkatërruese të fatkeqësive natyrore dhe ngjarjeve ekstreme të motit po i detyrojnë njerëzit të emigrojnë në zona më të sigurta.

Sipas një raporti të vitit 2022 nga IOM-i, gjatë dekadës së fundit mesatarisht 21,6 milionë njerëz në nivel global duhej të emigronin brenda vendeve të tyre për shkak të vështirësive që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike.

Raporti paralajmëron se në dekadën e ardhshme rreziqet e ndryshimeve klimatike janë në rritje në nivel global, me rreth 1 miliard njerëz që pritet të përballen me çështje si rritja e nivelit të detit, përmbytjet, thatësitat, temperaturat ekstreme dhe siguria ushqimore.

Sipas raportit, nga viti 2012 deri në vitin 2021 rajonet më të prekura nga ngjarjet e motit të lidhura me ndryshimet klimatike ishin Azia Lindore dhe Paqësori, Azia Juglindore, Afrika Sub-Sahariane, Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore, si dhe Evropa dhe Azia Qendrore.

Raporti thekson se numrat mund të ndryshojnë në bazë të nivelit të ngrohjes globale dhe rritjes së popullsisë. Ai thotë se nga 44 milionë deri në 113 milionë njerëz pritet të emigrojnë brenda vendeve të tyre deri në vitin 2050.

Megjithatë, sipas një skenari pesimist me ndryshime më të rënda klimatike, ky numër mund të arrijë midis 125 milionë dhe 216 milionë.

Raporti gjithashtu rendit rajonet me lëvizshmërinë njerëzore më të lartë të parashikuar deri në vitin 2050, përkatësisht vendet e Afrikës Sub-Sahariane, Azinë Lindore dhe Paqësorin, Azinë Jugore, Azinë Veriore, Amerikën Latine, Evropën dhe Azinë Qendrore. Raporti thekson se rritja e nivelit të detit mund të çojë në 750 mijë emigrantë klimatik në brigjet e Afrikës Lindore nga vitit 2020 deri në vitin 2050. Një rritje e nivelit të detit prej 0,44 metrash mund të rezultojë në 730 mijë emigrantë klimatik, ndërsa një rritje prej 2 metrash mund të çojë në 2,1 milionë emigrantë klimatik deri në vitin 2100.

Melike Dedeoğlu nga IOM-i, anëtare e Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkenca Administrative në Universitetin Erciyes në Turqi, për Anadolu tha se "emigrantë klimatik" nga IOM-i quhen individët që detyrohen të lëshojnë vendet e tyre, përkohësisht ose përgjithmonë, për shkak të ngjarjeve klimatike dhe mjedisore që ndikojnë negativisht në jetën ose kushtet e tyre të jetesës.

Dedeoğlu tha se arsyet e emigrimit të emigrantëve klimatik mund të ndryshojnë, faktorë si fatkeqësitë e lidhura me klimën, ulja e produktivitetit bujqësor, mungesa e ujit, thatësira dhe temperaturat ekstreme.

<https://www.aacom.tr>

1. Si mund t'i definojmë "emigrantët klimatik" sipas IOM-ës?

1 pikë

2. Organizata Ndërkombëtare për Emigracion jep parashikimin e fluksit më të madh të emigrantëve klimatik, sa do të jetë numri dhe deri në cilin vit bëhen parashikimet?

1 pikë

3. Sipas raportit të 2012 deri në 2050 sipas skenarit pesimist do të migrojnë:

1. 44 milionë deri në 216 milionë
2. 44 milionë deri në 122 milionë
3. 55 milionë deri në 150 milionë
4. 125 milionë deri në 216 milionë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

4. Sa dhe në cilin vit pritet të ndodhë rritja më e madhe e emigrantëve?

1 pikë

5. Numëroni faktorët që ndikojnë në emigrimin e "emigrantëve klimatik".

2 pikë

Lexo vargjet nga poezia "Paraja" e Hasan Zyko Kamberit dhe zhvillo detyrat 6, 7, 8 dhe 9.

Mbreti q'urdhëron dynjanë,
Që ka vënë taraphanë,
E i presënë paranë,
Ja di kimenë parasë.

Dhe veziri, q'është veqil,
Zë sikur të bënet' adil
E mos thotë dot kalykil,
Ja di kimenë parasë.

Sheh Islami q'ep fetfanë,
Që di qitapëtë ç'thanë,
Nukë kaçirdis paranë,
Ja di kimenë parasë.

Myfti edhe myderizë
Edhe kyrra e vaizë
Kanë ujdisur iblizë,
ja di kimenë parasë...

6. Cilës lëvizje letrare i përkasin vepra dhe autori?

1 pikë	
--------	--

7. A) Duke pasur parasysh përmbajtjen dhe formën, vepra është:

1. poemë satirike
2. këngë epike
3. epope
4. tingëllimë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

B) Argumento përgjigjen

1 pikë	
--------	--

8. Çfarë përfaqëson "Paraja" në këtë tekst poetik? Rrethoje përgjigjen e saktë.

burimin e ekzistencës

forcën djallëzore

nevojën për ta pasur

mungesën e saj

dëshirën për të shpenzuar

1 pikë	
--------	--

9. Si quhet vargu që rimerret në fund të çdo strofe?

1 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin e veprës "Pas vdekjes", pastaj zhvillo detyrat 10, 11, 12 dhe 13.

Vurkua(*duke unjur*): T'u ngjatë jeta, doktor Adham-Uti! Besa gëzohem që njojtat sot zotërinë tënde! Nder i math, për zonë! Unë jam Vurkua, korrespondenti i gazetës "Rrufeja".

Adham-Uti: A! Qënki gazetar!

Vurkua: Ndaj të lutem të më thuash ç'mendonën njerz't e mëdhenj për Shqipërinë, që të shkruajmë në gazetën tonë.

Adham-Uti: Domethënë, ti kërkon sot nga unë "intervieë"?

Vurkua: Po, Zotëni, që ta botoj te "Rrufeja".

Adham-Uti: Mos thuaj "Rrufeja" po thuaj "Rrufe"! Rrufe, rrufe; liri, liria dhe jo liri! Do t'i them dhe Skendo beut! Kjo gjuhë që përdorni ju sot s'është shqip! Pun'e gjuhës ka rënë në duar të liga dhe kurrë s'ka për të vatur mbarë!... Abetari që përdorni ju sot s'është për të qenë!...

Vurkua(*i mpirë*): Qysh! Po e ka vendosur Kongresi i Manastirit...

Adham-Uti(*me rrembim*): Kongresi i Manastirit? Ç'është ky Kongres i Manastirit? Kush vate? A vajta unë?

Vurkua (*duke qeshur*): Pse s'vajte, or zot?

Adham-Uti: A! a ! Përpara më thoshe: doktor efendi, tani qënkam vetëm zot, se fola të vërtetën! Thash' ato që janë! Dhe guxon të më kërkosh „intervieë"! Jo, jo, s'skam zakon unë, të jap „intervieë", jo për gazetatat tuaja.

10. Sheno emrin e personazhit të tretë që është pjesë e këtij dialogu në vepër?

1 pikë	
--------	--

11. Veço pjesë nga teksti që e bëjnë Adham-Utin komik në këtë fragment?

1 pikë	
--------	--

12. A) Si quhen fjalët e shënuara në kllapa me shkronja korsive?

1 pikë	
--------	--

B) Shpjego funksionin e tyre në tekst?

1 pikë	
--------	--

13. Vepra letrare është një komedi me tematikë:

1. socio-ekonomike
2. politiko-shoqërore
3. kulturo-artistike

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

14. Emërto figurën stilistike të përdorur në shprehjen e mëposhtme:

“nder i turpshëm”

1 pikë	
--------	--

15. Rrethoje cilës lëvizje filozofike letrare i përket ky koncept mbi njeriun:

Koncepti i "njeriut të natyrës", një qenie që është rritur dhe jeton e lirë në gjirin e natyrës, e pa shqetësuar nga hallet e botës dhe e pa molepsur nga të këqijat që fitohen në një shoqëri ku sundojnë padrejtësia dhe dhuna.

Romantizmit

Iluminizmit

Klasicizmit

1 pikë

16. Shëno pesë karakteristika, të cilat autorët e klasicizmit kujdeseshin që t'i përdornin në veprat e tyre?

_____, _____, _____,
_____, _____.

2 pikë

17. Mbi bazën e cilit parim krijonin krijuesit e klasicizmit?

1 pikë

18. Nisur nga parimet estetike që i vënë në bazë të artit të tyre autorët realist, vendos emrat përkatës (Balzaku, Stendali, Floberi, Çehovi):

	Kërkon që artisti të jetë <i>objektiv</i> dhe impersonal
	Përpunoi teorinë e <i>shpëtimit estetik</i> të personazheve
	Krijoi teorinë e <i>tipit letrar</i> , që nënkupton paraqitjen e karaktereve tipike në rrethana tipike
	"Arti i të shkruarit është arti i të shkruarit", shmangia e gjërave të tepërta sidomos e përshkrimeve dhe e situatave.

2 pikë

19. Plotëso fjalinë me një pjesë të nënrenditur:

Buna iu duk një lumë i gjatë dhe i bukur.

Vendore _____

Kohore _____

2 pikë

20. Në vend të shprehjeve të huaja përdor fjalë shqipe:

konfidencë _____

influcncë _____

konkluzion _____

1 pikë

21. Rishkruaji si duhet fjalët:

petagog	
arithmetikë	
diplomë	
zologji	
mencë	

2 pikë

22. Shkruaj sinonimin dhe antonimin e foljes shkoj:

Sinonimi _____

Antonimi _____

1 pikë

23. Ktheje foljen nga forma veprorë në formën joveprorë.

Mësova ta dua veten para tjetrit.

1 pikë

24. Shkruaj një lutje ose kërkesë zyrtare për të kërkuar një bursë për studime. Respekto rregullat për shkrimin e lutjes siç është parashtrimi i përmbajtjes dhe elementet e tjera të strukturës së saj.

Respekto formën e tekstit me të gjitha të dhënat e domosdoshme që duhet të ketë një kërkesë si dhe respekto gjuhën standarde.

8 pikë	
--------	--

[illegible]

[illegible]

25. Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

- Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumente qëndrimet personale.
- Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10%
(vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse esesa ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Esesa DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (esesë e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).
- Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. Poema "Korbi"- Edgar Allan Poe

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj për veçoritë artistike të veprës, struktura, lloji i vargut, strofa
- Efekti i simbolit – Korbi, simbolika e tij
- Cili është efekti përfundimtar që përftohet nga kjo poemë?

Fragment nga vepra

Një mesnate të bezdisur
Tek këndonja i zalisur
Disa prralla dhe magjira
Të një shkence të harruar,
Tek dremetja i kapitur
Befas vjen një e trokitur,
Me ngadale e goditur
Përmi derë t'odës sime.
"Dikush është, thashë, jashtë
Që troket mbi derën time".
Vetëm kjo dhe asgjë më.

Ah, e mbanj nër mënt fort mirë,
Ishte dimr' i ftoht' i ngrirë
Dhe n'oxhakun shkrump të nxirë
Urët shuheshin në hi.
Desha të gëdhihej dita,
Se më kot nga librat prita
Të më ngushëllonte drita
Për të lumturën Lenorë,
Vajzë e rallë dhe rrezore

Q' i thon Engjëjtë Lenorë,
Përmi dhe pa emër më.

Era frynte që përjashta,
Rrihte perdet e mëndafshta
Dhe më ngjethte dhe më derdhte
Tmere që s'i ndjeva kurrë.
Dhe tani, që të pushonte
Zemr' e mjerë që lëftonte,
Goja po më bëlbëzonte:
"Dikush do të hyjë brënda.
Kjo do jet' e asgjë më".


2. Rruga drejt suksesit

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj sa është e rëndësishme të jesh i suksesshëm në jetë.
- Shkruaj si duhet ta ruajmë suksesin, karakterin dhe identitetin personal.
- Shkruaj ndonjë model suksesi konkret tek i cili gjen motivim.

13 pikë

[illegible]





www.iccg.co.me